



**KRYEMINISTRIA**  
**MINISTËR SHTETI PËR SIPËRMARRJEN DHE KLIMËN E BIZNESIT**  
**KABINETI**

Tiranë, më 18. 01. 2025

# **RAPORT MBI DERREGULLIMIN E SHËRBIMEVE PËR BIZNESIN**

**Bazuar ne dokumentin e shqyrtuar në mbledhjen e Komitetit të  
Planifikimit Strategjik (KPS) të dates 17.01.2024**

## **PËRMBAJTJA**

<b>I. PËRMBLEDHJE E PROCESIT DHE REZULTATET .....</b>	<b>2</b>
<b>II. RAPORTET PËR SHËRBIMET NDAJ BIZNESEVE SIPAS MINISTRIVE.....</b>	<b>6</b>
1. MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT (MTM).....	6
2. MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT (MAS) .....	9
3. MINISTRIA E BRENDSHME (MB).....	12
4. MINISTRIA E MBROJTJES (MM) .....	15
5. MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL (MBZHR).....	17
6. MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT (MEKI).....	19
<b>III. ANEX – LISTA E AKTEVE DERREGULLUESE.....</b>	<b>21</b>
1. MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT (MTM).....	21
2. MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT (MAS) .....	22
3. MINISTRIA E BRENDSHME (MB).....	23
4. MINISTRIA E MBROJTJES (MM) .....	23
5. MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL (MBZHR).....	24
6. MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT (MEKI).....	25

## I. PËRMBLEDHJE E PROCESIT DHE REZULTATET

Shërbimet publike janë një element kyç i marrëdhënieve midis shtetit dhe qytetarëve apo bizneseve. Megjithëse administrata publike shqiptare ka bërë hapa të rëndësishëm në modernizimin e proceseve, nevoja për thjeshtim dhe përmirësim të mëtejshëm mbetet një objektivi i qartë. Procedurat ekzistuese shpesh janë komplekse dhe kërkojnë kohë të gjatë për t'u përfunduar, duke shtuar barrën administrative për përdoruesit. Në këtë kontekst, procesi i derregullimit është konceptuar si një përpjekje për të përmirësuar mënyrën se si ofrohen shërbimet publike, duke synuar lehtësimin e këtyre procedurave pa cenuar cilësinë apo sigurinë.

Qëllimi i këtij procesi nuk është të ndryshojë rrënjësisht administratën, por të adresojë sfidat e saj kryesore dhe të përmirësojë marrëdhëniet me qytetarët dhe bizneset. Në thelb, derregullimi synon të krijojë një administratë që operon me më shumë efikasitet, duke thjeshtuar procedurat, reduktuar kërkesat për dokumente dhe duke përshpejtuar ofrimin e shërbimeve përmes dixhitalizimit. Kjo iniciativë ka si objektivi kryesor lehtësimin e qasjes së bizneseve ndaj shërbimeve publike. Përmes reduktimit të kriterëve dhe dokumenteve të kërkuara dhe përmirësimit të ndërveprimit midis institucioneve, synohet që administrata publike të bëhet më miqësore dhe më e aksesueshme. Po ashtu, ky proces adreson një nga sfidat më të mëdha të administratës: ofrimin e shërbimeve në mënyrë të standardizuar dhe transparente.

### Metodologjia e Punës

Për të siguruar që procesi i derregullimit të shërbimeve publike të jetë i suksesshëm dhe efektiv, u ndoq një metodologji e mirëpërcaktuar dhe gjithëpërfshirëse. Kjo metodologji, e bazuar në analiza të hollësishme të shërbimeve ekzistuese, u konceptua si një proces ndërinstitucional, ku çdo ministri dhe institucion i saj vartës luajti një rol të rëndësishëm. Qasja kishte për qëllim adresimin e sfidave kryesore të procedurave administrative dhe identifikimin e hapave konkretë për përmirësimin e tyre, duke synuar një administratë më efikase dhe më të aksesueshme për qytetarët dhe bizneset.

Faza e parë e procesit të derregullimit u përqendrua në identifikimin dhe kategorizimin e shërbimeve publike. Ky proces kishte si bazë përcaktimet ligjore të ofrimit të shërbimeve, ku pika 10 e nenit 4 të ligjit nr. 13/2016 “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë” përcakton qartë se me shërbim publik kuptohet produkti që u ofrohet qytetarëve dhe bizneseve nga institucionet e administratës shtetërore, të pavarura dhe të qeverisjes vendore. Ky produkt mund të jetë certifikatë, licencë, leje, vërtetim apo forma të tjera të përcaktuara në legjislacion. Gjithashtu, ligji nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shërbeu si një bazë ligjore e rëndësishme për këtë fazë. Ky ligj synon përmirësimin e klimës së biznesit përmes reduktimit të barrierave administrative dhe nxitjes së nismës së lirë për veprimtari ekonomike, tregtare apo profesionale. Ai thekson rëndësinë e balancimit midis lehtësimit të procedurave administrative dhe garantimit të mbrojtjes së interesit publik. Puna në këtë fazë konsistoi në mbledhjen dhe analizën e të dhënave nga të gjitha institucionet shtetërore dhe agjencitë vartëse, duke krijuar një

inventar të plotë të shërbimeve publike. Çdo ministri dhe institucion u angazhua për të evidentuar shërbimet që ofron dhe për të kategorizuar ato sipas natyrës: ato për qytetarët dhe ato për bizneset. Lista përfshinte të dhëna të detajuara mbi:

- Aktin ligjor/nënligjor që parashikon shërbimin e ofruar;
- Kriteret e përcaktuara për shërbim;
- Kriteret që vlerësohet se mund të hiqen/kriteret që vlerësohet se mund të qëndrojnë;
- Lista e dokumenteve që kërkohet për shërbim;
- Lista e dokumenteve që mund të hiqen/ që vlerësohet se duhet të qëndrojnë;
- Lista e dokumentave që mund të merrem me ndërveprim /apo drejt përdrejt nga vetë institucioni;
- Lista e dokumentave që duhet të sillet nga kërkuesi i shërbimit;
- Afatet kohore
- Tarifat
- Procedura e lëvrimit të shërbimit

Kjo fazë nuk synonte vetëm një evidentim të thjeshtë të shërbimeve ekzistuese, por gjithashtu vendosi bazat për analizat e mëvonshme, ku do të vlerësoheshin mundësitë për thjeshtim, dixhitalizim dhe përmirësim të mëtejshëm. Me një bazë të fortë ligjore dhe një strukturë të qartë të të dhënave, procesi i identifikimit hapi rrugën për fazat pasuese të derregullimit.

Pas këtij identifikimi, faza e dytë ishte analiza e dokumentacionit dhe procedurave. Në këtë hap, u shqyrtuan në detaje të gjitha procedurat e lidhura me shërbimet, duke vlerësuar hapat proceduralë, dokumentet e kërkuara dhe kriteret përkatëse. Analiza kishte si qëllim të identifikonte hapat e panevojshëm, dokumentet e tepërta dhe çdo pengesë tjetër që shtonte barrën administrative. Ky proces ndihmoi gjithashtu në evidentimin e problematikave specifike të secilit institucion dhe krijoi një bazë për propozime të ndryshimeve konkrete.

Një element kyç i metodologjisë ishte bashkëpunimi ndërinstitucional dhe konsultimet me grupet e interesit. Për të siguruar që ndërhyrjet të ishin gjithëpërfshirëse dhe në përputhje me nevojat reale, u organizuan tryeza të shumta diskutimi me përfaqësues të ministrive dhe agjencive vartëse. Në këto takime u ndanë gjetjet fillestare dhe u diskutuan propozimet për ndryshime. Një rol të rëndësishëm luajti gjithashtu përfshirja e përfaqësuesve të sektorit privat dhe shoqatave të biznesit. Në takimet e organizuara me këto grupe, u shpjegua procesi i derregullimit që po ndërmerre qeveria shqiptare dhe u ofrua mundësia për pjesëmarrjen e tyre aktive. U shpërndanë lista me shërbimet përkatëse të çdo sektori, duke ftuar për komente dhe sugjerime konkrete mbi problematikat dhe nevojat e hasura gjatë përdorimit të shërbimeve publike. Përfaqësues nga shoqata të ndryshme të biznesit dhe sektorë specifikë të ekonomisë (si turizmi, bujqësia, tregtia dhe industria e përpunimit) ishin pjesë e këtyre diskutimeve. Kalendari i takimeve u përcaktua për të adresuar shërbimet në fusha të ndryshme, duke siguruar që çdo sektor të përfaqësohej dhe të kontribuonte. Këto diskutime kontribuan në identifikimin e problematikave kryesore, përmirësimin e propozimeve dhe përafrimin e shërbimeve me nevojat praktike të përdoruesve. Në këto tryeza, shoqatat e biznesit ofruan komente të vlefshme mbi procesin aktual, si për shembull vështirësitë për të siguruar dokumentacionin e duhur, mungesën e dixhitalizimit të disa shërbimeve dhe ndërlikimet administrative që hasen gjatë ndërveprimit me institucionet publike.

Hapi përfundimtar i procesit të derregullimit ka qenë hartimi dhe miratimi i ndryshimeve ligjore dhe nënligjore, të cilat formalizojnë ndërhyrjet e propozuara për përmirësimin e shërbimeve publike. Përpara këtij hapi, u hartuan raportet për secilin institucion, të cilat përshkruajnë në detaje analizat dhe rekomandimet për ndryshime. Këto raporte përbëjnë bazën për hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore. Puna u përqendrua në përshtatjen e bazës ligjore me rekomandimet e dala nga analizat dhe konsultimet, duke siguruar që çdo ndryshim të jetë i qartë, i zbatueshëm dhe në përputhje me qëllimet e procesit. Miratimi i këtyre ndryshimeve shënon një moment të rëndësishëm në proces, duke ofruar kornizën e nevojshme për zbatimin efektiv të përmirësimeve dhe për sigurimin e një administrate më efikase dhe më të thjeshtë për qytetarët dhe bizneset.

Procesi i derregullimit u drejtua nga një grup ndërinstitucional pune, i ngritur me urdhrin nr. 209, datë 7. 12. 2023 të Kryeministrit. Ky grup përfshinte drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje, drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, zëvendësministrat e ministrive kryesore, drejtues të agjencive vartëse dhe kryesohej nga Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit. Grupi i punës luajti një rol të rëndësishëm në koordinimin e aktiviteteve dhe në sigurimin që të gjitha institucionet të kontribuonin në mënyrë të harmonizuar në proces.

Një aspekt i rëndësishëm i metodologjisë ishte monitorimi i vazhdueshëm i progresit dhe koordinimi midis institucioneve. Përmes takimeve periodike ndërinstitucionale, u vlerësua ecuria e procesit dhe u diskutuan sfidat e hasura. Ministritë dhe agjencitë raportuan rregullisht mbi arritjet dhe pengesat, duke siguruar që çdo hap të jetë në përputhje me objektivat e vendosura.

Metodologjia e ndjekur, e ndërtuar mbi analiza të thelluara dhe konsultime gjithëpërfshirëse, ka garantuar një qasje sistematike dhe të strukturuar për realizimin e procesit të derregullimit. Kjo metodologji ka siguruar që ndërhyrjet të jenë të orientuara drejt rezultateve konkrete dhe të qëndrueshme, duke krijuar një bazë të fortë për përmirësimin e vazhdueshëm të administratës publike.

Hapi përfundimtar i procesit të derregullimit ka qenë hartimi dhe miratimi i ndryshimeve ligjore dhe nënligjore, të cilat formalizojnë ndërhyrjet e propozuara për përmirësimin e shërbimeve publike. Përpara këtij hapi, u hartuan raportet për secilin institucion, të cilat përshkruajnë në detaje analizat dhe rekomandimet për ndryshime. Këto raporte përbëjnë bazën për hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore. Puna u përqendrua në përshtatjen e bazës ligjore me rekomandimet e dala nga analizat dhe konsultimet, duke siguruar që çdo ndryshim të jetë i qartë, i zbatueshëm dhe në përputhje me qëllimet e procesit. Miratimi i këtyre ndryshimeve shënon një moment të rëndësishëm në proces, duke ofruar kornizën e nevojshme për zbatimin efektiv të përmirësimeve dhe për sigurimin e një administrate më efikase dhe më të thjeshtë për qytetarët dhe bizneset.

Procesi i derregullimit u drejtua nga një grup ndërinstitucional pune, i ngritur me urdhrin nr. 209, datë 7. 12. 2023 të Kryeministrit. Ky grup përfshinte drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje, drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së

Informacionit, zëvendësministrat e ministrive kryesore, drejtues të agjencive vartëse dhe kryesohej nga Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit. Grupi i punës luajti një rol të rëndësishëm në koordinimin e aktiviteteve dhe në sigurimin që të gjitha institucionet të kontribuonin në mënyrë të harmonizuar në proces.

Një aspekt i rëndësishëm i metodologjisë ishte monitorimi i vazhdueshëm i progresit dhe koordinimi midis institucioneve. Përmes takimeve periodike ndërinstucionale, u vlerësua ecuria e procesit dhe u diskutuan sfidat e hasura. Ministrinë dhe agjencitë raportuan rregullisht mbi arritjet dhe pengesat, duke siguruar që çdo hap të jetë në përputhje me objektivat e vendosura.

Metodologjia e ndjekur, e ndërtuar mbi analiza të thelluara dhe konsultime gjithëpërfshirëse, ka garantuar një qasje sistematike dhe të strukturuar për realizimin e procesit të derregullimit. Kjo metodologji ka siguruar që ndërhyrjet të jenë të orientuara drejt rezultateve konkrete dhe të qëndrueshme, duke krijuar një bazë të fortë për përmirësimin e vazhdueshëm të administratës publike.

## **Rezultatet e Përgjithshme të Procesit të Derregullimit**

### **1. Totali i Shërbimeve të Ofruara**

Në kuadër të procesit të derregullimit, janë analizuar gjithsej 282 shërbime publike të ofruara nga ministrinë dhe institucionet e tyre vartëse. Këto përfshijnë shërbime që u ofrohen bizneseve në sektorë të ndryshëm si turizmi, mjedisi, arsimiti, mbrojtja etj.

### **2. Shërbime që do të Përmirësohen**

Në total, 126 shërbime, ose 45% e totalit, do të përfshihen në procesin e përmirësimit, duke përfshirë reduktimin e dokumentacionit, shkurtrimin e afateve dhe thjeshtimin e procedurave.

### **3. Totali i Dokumenteve**

Për ofrimin e shërbimeve të përmirësuara, aktualisht kërkohen 999 dokumente.

### **4. Dokumentacioni që Reduktohet**

Pas analizave dhe propozimeve të bëra, është parashikuar eliminimi i 246 dokumenteve, që përfaqëson një ulje prej 25% të totalit të dokumenteve të kërkuara.

### **5. Shërbime për të Cilët Reduktohet Koha e Ofrimit**

Koha e ofrimit do të reduktohet për 124 shërbime, që përfaqësojnë 44% të totalit të shërbimeve.

### **6. Totali i Kohës së Ofrimit të Shërbimeve**

Aktualisht, për përfundimin e shërbimeve të analizuara nevojiten gjithsej 4342 ditë.

### **7. Koha e Ofrimit të Shërbimeve që Reduktohet**

Pas zbatimit të ndryshimeve të propozuara, totali i kohës së ofrimit të shërbimeve do të reduktohet me 1011 ditë ose 23% të kohës totale.

### **8. Ndryshime Ligjore të Nevojshme**

Procesi i derregullimit kërkon ndryshime në bazën ligjore dhe nënligjore, duke përfshirë:

**Akte në Total:** 27 akte

**Ligje:** 3 ligje,

**Vendime të Këshillit të Ministrave (VKM):** 17 VKM

**Udhëzime dhe Urdhëra:** 7 akte

## II. RAPORTET PËR SHËRBIMET NDAJ BIZNESEVE SIPAS MINISTRIVE

### 1. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM)

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka identifikuar 31 shërbime publike që u ofrohen bizneseve dhe lidhen kryesisht me dhënien e lejeve, autorizimeve dhe certifikatave në fushën e turizmit dhe mjedisit. Shërbimet e MTM përfshijnë pajisjen me leje mjedisore të tipave A dhe B, aplikimet për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM), transferimin e vendimeve dhe deklaratave mjedisore, autorizimet për eksportin e mbetjeve dhe pajisjen me kode unike për transfertat e mbetjeve. Po ashtu, ministria ofron certifikata për operatorët turistikë dhe strukturat akomoduese, si dhe trajton kërkesat për stacionet e plazheve dhe turizmin detar.

#### Situata dhe Analiza

Gjatë procesit të derregullimit të shërbimeve të biznesit, u zhvilluan disa takime mes Ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen, përfaqësuesve të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, dhe grupeve të interesit. Diskutimet u përqendruan në analizimin e detajuar të shërbimeve ekzistuese, duke shqyrtuar:

- Kriteret e vendosura për shërbimet;
- Listën e dokumenteve të kërkuara për aplikime;
- Dokumentet që mund të sigurohen nga institucionet përmes ndërveprimit direkt;
- Afatet kohore për përpunimin dhe miratimin e aplikimeve;
- Procedurat e ndjekura për ofrimin e shërbimeve.

Nga analiza, u vërejt se disa shërbime kërkonin dokumente që mund të siguroheshin automatikisht nga sistemet ekzistuese. Për shembull, për aplikimin për certifikatë paraprake për veprimtari agroturizmi, aplikantët duhet të paraqisnin planin e biznesit dhe relacionin arkitektonik, të cilat krijonin punë shtesë për aplikuesit. Po ashtu, për certifikatat e operatorëve të turizmit detar, kërkohej dorëzimi manual i fotokopjes së ID dhe vërtetimeve tatimore, të cilat mund të siguroheshin nga QKB dhe sistemet tatimore. Në disa raste, koha e nevojshme për përfundimin e procedurave rezultonte e gjatë. Për shembull, vlerësimi i ndikimit mjedisor kërkonte deri në 45 ditë për shqyrtim, duke vonuar zbatimin e projekteve të reja. Një tjetër shembull ishin lejet për zhvillime transformuese, si ndërtimi i rrugëve dhe strukturave të mëdha, që kërkonin deri në 60 ditë për miratim.

Gjithashtu, mungesa e koordinimit ndërmjet institucioneve ishte një element që ndikonte në proces. Për lejet për zhvillim aktivitetesh turistike, aplikantët dorëzonin manualisht dokumente për pronësinë e tokës dhe vërtetime tatimore, ndërsa këto mund të siguroheshin nga ndërlidhja e sistemeve të ASHK-së dhe QKB-së. Një situatë e ngjashme ndodhte edhe me certifikatat e operatorëve turistikë, ku mungesa e ndërlidhjes ndërmjet Ministrisë së Turizmit dhe Drejtorisë së Tatimeve shkaktonte vonesa.

## Rekomandime

Gjatë takimeve, ministrja dha disa rekomandime për përmirësimin e procesit dhe lehtësimin e barrës për aplikantët:

**Dokumentacioni:** Të eliminohen dokumentet që mund të sigurohen automatikisht nga sistemet publike. Për shembull:

- Të hiqet plani i biznesit dhe relacioni arkitektonik nga aplikimet për certifikatë paraprake për agroturizëm.

- Të mos kërkohet dorëzimi i fotokopjes së ID dhe vërtetimeve tatimore për certifikatat e operatorëve të turizmit detar.

**Formularët dhe procedurat:** Të standardizohen kriteret dhe struktura e aplikimeve. Për shembull:

- Të krijohet një formular unik për aplikimet në stacione plazhi dhe certifikatat e agroturizmit.

- Të unifikohen aplikimet për regjistrimin e bizneseve në QKB në një format të vetëm.

**Koordinimi ndërmjet institucioneve:** Të ndërliken sistemet për të siguruar dokumente automatikisht pa përfshirë aplikantët. Për shembull:

- Verifikimi i të dhënave për pronësinë e tokës dhe vërtetimeve tatimore të bëhet automatikisht përmes ASHK-së dhe QKB-së.

- Të krijohet një sistem i ndarjes së informacionit ndërmjet Ministrisë së Turizmit dhe Drejtorisë së Tatimeve për të siguruar të dhëna mbi statusin financiar të operatorëve.

**Afatet kohore:** Të shkurtrohet koha e shqyrtimit të aplikimeve. Për shembull:

- Afati për vlerësimin e ndikimit mjedisor të reduktohet nga 45 ditë në 24 ditë pune.

- Koha për shqyrtimin e certifikatave të operatorëve turistikë të reduktohet nga 50 ditë në 30 ditë pune.

## Përfundime dhe Rezultate Kryesore

Rekomandimet e dhëna gjatë takimeve u reflektuan në analizën e shërbimeve dhe çuan në hartimin dhe miratimin e akteve ligjore dhe nënligjore përkatëse. Përmes këtyre akteve, ndryshimet e propozuara janë tashmë të realizuara për një pjesë të shërbimeve, ndërsa për të tjera procesi i zbatimit po vijon. Përmirësimet synojnë reduktimin e dokumentacionit, shkurtimin e kohës së ofrimit të shërbimeve dhe thjeshtimin e procedurave, duke ndihmuar në lehtësimin e aksesit për qytetarët dhe bizneset.

## Raport Analitik mbi Derregullimin e Shërbimeve MTM

### 1. Totali i Shërbimeve të Ofruara

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ofron gjithsej 31 shërbime publike, të cilat janë analizuar në kuadër të procesit të derregullimit.

### 2. Shërbime që do të Përmirësohen

15 shërbime, ose 48% e totalit, do të përfshihen në procesin e përmirësimit, duke reduktuar dokumentacionin, kohën dhe procedurat e ndërlikuara.

### 3. Totali i Dokumenteve

Për këto shërbime aktualisht kërkohen 98 dokumente.

### 4. Dokumentacioni që Reduktohet

Është propozuar eliminimi i 40 dokumenteve, që përbën një reduktim prej 41% të totalit të dokumenteve të kërkuara.

**5. Shërbime për të Cilët Reduktohet Koha e Ofrimit**

Koha e ofrimit do të reduktohet për 17 shërbime, që përfaqësojnë 55% të totalit të shërbimeve.

**6. Totali i Kohës së Ofrimit të Shërbimeve**

Aktualisht, për përfundimin e shërbimeve nevojiten gjithsej 511 ditë.

**7. Koha e Ofrimit të Shërbimeve që Reduktohet**

Pas zbatimit të ndryshimeve të propozuara, totali i kohës për ofrimin e shërbimeve do të reduktohet me 187 ditë që përbën një ulje prej 37% të kohës totale.

**8. Ndryshime Ligjore të Nevojshme**

Procesi i derregullimit kërkon ndryshime të bazës ligjore, përfshirë:

- Ligje të Ndryshuara: 1 ligj
- Vendime të Këshillit të Ministrave (VKM): 8 VKM
- Urdhëra: 2 urdhëra
- Udhëzime: 1 udhëzime



## 2. Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS)

Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) ofron një sërë shërbimesh që mbulojnë si arsimin parauniversitar, ashtu edhe arsimin e lartë, me një fokus të veçantë në rregullimin dhe mbështetjen e institucioneve arsimore dhe të operatorëve privatë që veprojnë në këtë sektor. Në arsimin e lartë, ministria siguron licencimin dhe akreditimin e institucioneve private dhe publike, duke përfshirë miratimin e programeve të reja studimore dhe hapjen e degëve të reja. Një aspekt i rëndësishëm është rregullimi i standarteve për diplomat dhe certifikatat e lëshuara, duke garantuar përputhshmërinë me kuadrin kombëtar të kualifikimeve. Për arsimin parauniversitar, MAS mbikëqyr procesin e licencimit të shkollave private dhe riorganizimin e institucioneve ekzistuese. Ky proces përfshin standardizimin e procedurave për miratimin e planeve mësimore dhe monitorimin e cilësisë së mësimdhënies. Për bizneset në fushën e arsimit, ministria ofron shërbime që përfshijnë licencimin e operatorëve privatë, miratimin e materialeve arsimore, si dhe certifikimin e të dhënave të nevojshme për zhvillimin e veprimtarive arsimore. Gjithashtu, për institucione të ndryshme, ministria trajton njohjen dhe njëvlerësimin e kualifikimeve ndërkombëtare për të siguruar integrimin e standardeve globale në procesin arsimor vendas.

### Situata dhe Analiza

Gjatë procesit të derregullimit të shërbimeve të biznesit, u zhvilluan disa takime mes Ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen, përfaqësuesve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS), dhe grupeve të interesit. Diskutimet u fokusuan në analizimin e detajuar të shërbimeve ekzistuese, duke shqyrtuar:

- Kriteret e vendosura për shërbimet;
- Listën e dokumenteve të kërkuara për aplikime;
- Dokumentet që mund të sigurohen nga institucionet përmes ndërveprimit direkt;
- Afatet kohore për përpunimin dhe miratimin e aplikimeve;
- Procedurat e ndjekura për ofrimin e shërbimeve.

Nga analiza, u evidentua se disa shërbime kërkonin dokumentacion të panevojshëm që mund të sigurohej automatikisht përmes institucioneve përkatëse. Për shembull, për hapjen e një programi të ri studimi, kërkoheshin plani financiar dhe raportet mbi infrastrukturën akademike, të cilat krijojnë kosto dhe vonesa për aplikantët. Një problematikë e ngjashme u has edhe te licencimi i institucioneve parauniversitare, ku dokumentacioni dhe procedurat përfshinin hapa manualë dhe afate të zgjatura. Në disa raste, koha për përfundimin e procedurave ishte shumë e gjatë. Për shembull, për mbylljen e një programi studimi, procedura kërkonte deri në 60 ditë, ndërsa për hapjen e degëve të reja në arsimin e lartë duheshin deri në 90 ditë. Gjithashtu, mungesa e koordinimit ndërinstitucional shkaktonte vonesa të mëtejshme, pasi dokumente si certifikatat e pronësisë dhe të dhënat financiare kërkoheshin manualisht, edhe pse mund të siguroheshin automatikisht përmes ndërlidhjes së sistemeve.

### Rekomandime

Gjatë takimeve, ministrja dha disa rekomandime për të përmirësuar procesin dhe për të lehtësuar barrën administrative për aplikantët:

**Dokumentacioni:** Të eliminohen dokumentet e tepërta dhe të sigurohen automatikisht nga sistemet ekzistuese. Për shembull:

- Për hapjen e programeve të reja studimore, të hiqet kërkesa për raportet mbi infrastrukturën dhe plani financiar.

- Të mos kërkohet dorëzimi manual i dokumenteve të pronësisë dhe të dhënave financiare për licencimin e institucioneve parauniversitare.

**Formularët dhe procedurat:** Të krijohen formularë unikë dhe të standardizohen kriteret për shërbime të ngjashme. Për shembull, të unifikohen aplikimet për licencimin e institucioneve arsimore dhe hapjen e programeve të reja studimore.

**Koordinimi ndërmjet institucioneve:**

- Të ndërliiden sistemet për të shmangur kërkesat për dorëzim manual të dokumenteve nga aplikantët.

- Të përdoren sistemet ekzistuese të QKB, DPT, për sigurimin automatik të të dhënave mbi pronësinë dhe statusin financiar të institucioneve.

**Afatet kohore:**

- Të reduktohen afatet për shërbimet kryesore.

- Për shembull, për mbylljen e programeve studimore, koha të reduktohet nga 60 ditë në 30 ditë, dhe për hapjen e degëve të reja në arsimin e lartë nga 90 ditë në 60 ditë.

## **Përfundime dhe Rezultate Kryesore**

Rekomandimet e dhëna gjatë takimeve u reflektuan në analizën e shërbimeve dhe çuan në hartimin dhe miratimin e akteve ligjore dhe nënligjore përkatëse. Përmes këtyre akteve, ndryshimet e propozuara janë tashmë të realizuara për një pjesë të shërbimeve, ndërsa për të tjera procesi i zbatimit po vijon. Përmirësimet synojnë reduktimin e dokumentacionit, shkurtimin e kohës së ofrimit të shërbimeve dhe thjeshtimin e procedurave, duke ndihmuar në lehtësimin e aksesit për qytetarët dhe bizneset.

## **Raport Analitik mbi Derregullimin e Shërbimeve MAS**

### **1. Totali i Shërbimeve të Ofruara**

Ministria e Arsimit dhe Sportit ofron gjithsej 23 shërbime publike, të cilat janë analizuar në kuadër të procesit të derregullimit.

### **2. Shërbime që do të Përmirësohen**

Në total, 14 shërbime, ose 61%, do të përfshihen në procesin e përmirësimit përmes reduktimit të dokumentacionit dhe procedurave të ndërlikuara.

### **3. Totali i Dokumenteve**

Për këto shërbime aktualisht kërkohen 185 dokumenta.

### **4. Dokumentacioni që Reduktohet**

Është propozuar eliminimi i 56 dokumente, 17 dokumente të tjerë nuk do ngarkohen nga biznesi, por do të sigurohen me ndërveprim nga administrata, që përbën një reduktim prej 39% të totalit të dokumenteve të kërkuara.

### **5. Shërbime për të Cilët Reduktohet Koha e Ofrimit**

Koha e ofrimit do të reduktohet për 3 shërbime, që përfaqësojnë 13% të totalit të shërbimeve.

### **6. Totali i Kohës së Ofrimit të Shërbimeve**

Aktualisht, për përfundimin e shërbimeve nevojiten gjithsej 240 ditë.

#### **7. Koha e Ofrimit të Shërbimeve që Reduktohet**

Pas zbatimit të ndryshimeve të propozuara, totali i kohës për ofrimin e shërbimeve do të reduktohet në 150 ditë, duke kursyer 90 ditë, që përbën një ulje prej 38% të kohës totale.

#### **8. Ndryshime Ligjore të Nevojshme**

Procesi i derregullimit kërkon ndryshime të bazës ligjore dhe nënligjore, përfshirë:

- Ligje të Ndryshuara: Asnjë
- Vendime të Këshillit të Ministrave (VKM): 2 VKM.
- Urdhëra: Asnjë
- Udhëzime: 1

### 3. Ministria e Brendshme (MB)

Ministria e Brendshme ofron një gamë të gjerë shërbimesh që mbulojnë sigurinë publike, menaxhimin e emergjencave dhe regjistrimet civile. Ndër shërbimet kryesore për bizneset përfshihen autorizimet për përdorimin e armëve të zjarrit nga operatorët privatë të sigurisë, licencat për kompanitë e shërbimeve të sigurisë dhe certifikimet për pajisje dhe struktura që kërkojnë standarde të veçanta sigurie. Për sektorin e sigurisë private, ministria ofron licenca për hapjen dhe funksionimin e kompanive të ruajtjes fizike, si dhe autorizime për përdorimin e mjeteve të specializuara, përfshirë armët e zjarrit dhe pajisjet e blinduara. Për shërbimet e lidhura me emergjencat, Ministria e Brendshme lëshon certifikata për përputhjen me standardet e sigurisë nga zjarri dhe autorizimet për objektet që i nënshtrohen rregulloreve të veçanta. Në fushën e menaxhimit të të dhënave, ministria mbikëqyr proceset për ndryshimet në regjistrat civilë, përfshirë regjistrimin e adresave dhe përditësimin e të dhënave personale. Këto shërbime garantohen në nivel kombëtar, duke siguruar përputhshmërinë me standardet ligjore dhe teknologjike për akses më të shpejtë dhe më transparent për bizneset dhe qytetarët.

#### Situata dhe Analiza

Gjatë procesit të derregullimit të shërbimeve të Ministrisë së Brendshme, u zhvilluan takime ndërmjet Ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen, përfaqësuesve të Ministrisë së Brendshme, dhe grupeve të interesit. Diskutimet u fokusuan në analizimin e shërbimeve ekzistuese, duke shqyrtuar:

- Kriteret e vendosura për shërbimet;
- Listën e dokumenteve të kërkuara për aplikime;
- Dokumentet që mund të sigurohen automatikisht nga institucionet përmes ndërveprimit direkt;
- Afatet kohore për përpunimin dhe miratimin e aplikimeve;
- Procedurat e ndjekura për ofrimin e shërbimeve.

Nga analiza, u identifikua një barrë e konsiderueshme administrative për aplikantët, për shkak të dokumenteve të shumta që kërkoreshin për shërbime të ndryshme. Për shembull, për aplikimin për faturë për arkëtim për subjektet kundravajtës, kërkoreshin licenca dhe ekstrakte historike, të cilat mund të siguroheshin automatikisht nga sistemet ekzistuese. Po ashtu, shërbimet si pajisja me autorizim për blerje armë zjarri për personat juridik kërkonin një numër të madh dokumentesh manuale që mund të reduktoheshin përmes ndërlidhjes së sistemeve. Gjithashtu, afatet kohore për përfundimin e procedurave rezultojnë të zgjatura dhe pengonin qasjen e shpejtë të bizneseve. Për shembull, autorizimet për përdorimin e mjeteve të blinduara dhe miratimet për depot e magazinimit të lëndëve plasëse kërkonin deri në 60 ditë për shqyrtim.

#### Rekomandime

Gjatë takimeve, u dhanë rekomandime specifike për thjeshtimin e procedurave dhe lehtësimin e barrës administrative:

**Dokumentacioni:** Eliminimi i dokumenteve që mund të sigurohen automatikisht nga institucionet publike. Për shembull:

- Të hiqet ekstrakti historik dhe të përdoret vetëm NIPT-i për aplikimet e shërbimeve kundravajtëse.

- Të eliminohet kërkesa për fotokopje të ID dhe dokumentet për verifikime tatimore, pasi këto mund të sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Policia e Shtetit.

**Formularët dhe Procedurat:** Të standardizohen aplikimet për të gjithë kategoritë e shërbimeve. Për shembull:

- Formularët për aplikimet për armë zjarri dhe autorizime për mjete të blinduara të unifikohen dhe të përfshijnë deklaratat vetë-dëshmuese nga aplikantët.

- Të krijohet një proces i veçantë për depot e magazinimit, duke unifikuar kërkesat për certifikime.

**Koordinimi Ndërinstitucional:** Ndërlidhja e sistemeve për të siguruar dokumente automatikisht pa përfshirë aplikantët. Për shembull:

- Verifikimi i gjendjes civile dhe penalitetit të realizohet përmes sistemit elektronik në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

- Të sigurohet që licencat dhe autorizimet të merren automatikisht nga AKSHE dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë përmes sistemit SQDNE.

**Afatet Kohore:** Shkurtimi i afateve për shqyrtimin e aplikimeve. Për shembull:

- Për faturat për arkëtim për subjektet kundravajtës, afati të reduktohet nga 10 ditë në 2 ditë.

- Autorizimet për blerjen e armëve të reduktohen nga 60 ditë në 30 ditë.

## **Përfundime dhe Rezultate Kryesore**

Rekomandimet e dhëna gjatë takimeve u reflektuan në analizën e shërbimeve dhe çuan në hartimin dhe miratimin e akteve ligjore dhe nënligjore përkatëse. Përmes këtyre akteve, ndryshimet e propozuara janë tashmë të realizuara për një pjesë të shërbimeve, ndërsa për të tjera procesi i zbatimit po vijon. Përmirësimet synojnë reduktimin e dokumentacionit, shkurtimin e kohës së ofrimit të shërbimeve dhe thjeshtimin e procedurave, duke ndihmuar në lehtësimin e aksesit për qytetarët dhe bizneset.

## **Raport Analitik mbi Derregullimin e Shërbimeve MB**

### **1. Totali i Shërbimeve të Ofruara**

Ministria e Brendshme ofron gjithsej 17 shërbime publike, të cilat janë analizuar në kuadër të procesit të derregullimit.

### **2. Shërbime që do të Përmirësohen**

Në total, 6 shërbime, ose 35%, do të përfshihen në procesin e përmirësimit përmes reduktimit të dokumentacionit.

### **3. Totali i Dokumenteve**

Për këto shërbime aktualisht kërkohen gjithsej 68 dokumenta.

### **4. Dokumentacioni që Reduktohet**

Është propozuar eliminimi i 8 dokumenteve, që përbën një reduktim prej 12% të totalit të dokumenteve të kërkuara.

### **5. Shërbime për të Cilët Reduktohet Koha e Ofrimit**

Nuk do të ketë ndryshime

### **6. Totali i Kohës së Ofrimit të Shërbimeve**

Nuk do të ketë ndryshime

### **7. Koha e Ofrimit të Shërbimeve që Reduktohet**

Nuk do të ketë ndryshime

## **8. Ndryshime Ligjore të Nevojshme**

Procesi i derregullimit kërkon përmirësime të bazës ligjore dhe nënligjore, përfshirë:

- Ligje të Ndryshuara: Nuk ka.
- Vendime të Këshillit të Ministrave (VKM): Nuk ka.
- Urdhëra: Nuk ka.
- Udhëzime: 3 udhëzime.

## 4. Ministria e Mbrojtjes (MM)

Ministria e Mbrojtjes ofron një sërë shërbimesh të specializuara për bizneset që veprojnë në sektorin e sigurisë dhe teknologjisë ushtarake, duke përfshirë licenca, autorizime dhe akses në dokumentacion teknik. Ndër shërbimet kryesore janë licencat për eksport dhe import të mallrave dhe teknologjive me përdorim ushtarak ose të dyfishtë, të cilat lehtësojnë aktivitetet e prodhuesve dhe tregtarëve të pajisjeve ushtarake. Ky proces do të dixhitalizohet tërësisht për të reduktuar dokumentacionin fizik dhe për të përshpejtuar përpunimin përmes ndërveprimit institucional. Gjithashtu, Ministria trajton autorizimet për përdorimin e teknologjive me përdorim të dyfishtë, duke siguruar shqyrtim teknik dhe përputhshmëri me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare. Këto shërbime janë thelbësore për garantimin e standardeve të sigurisë dhe përdorimit të ligjshëm të teknologjive të ndjeshme. Në fushën e pajisjeve të specializuara, Ministria lëshon autorizime për përdorimin dhe tregtimin e mjeteve si pajisjet e blinduara dhe teknologjitë e mbrojtjes kibernetike, duke siguruar certifikimin e standardeve dhe përputhshmërisë. Këto masa ndihmojnë në përmirësimin e efikasitetit dhe transparencës në ofrimin e shërbimeve për bizneset.

### Situata dhe Sfidat

Nga analiza e realizuar dhe diskutimet gjatë takimit me përfaqësuesit e Ministrisë së Mbrojtjes, janë identifikuar disa sfida kryesore që ndikojnë në efikasitetin e ofrimit të shërbimeve publike:

- **Dokumentacion i panevojshëm dhe përsëritës:** Për shërbime si licencat për eksport/import të mallrave ushtarake dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë, kërkohet një numër i madh dokumentesh, shumë prej të cilave mund të sigurohen përmes ndërveprimit institucional. Kjo përfshin vërtetimet nga gjykatat, Prokuroria dhe përmbarimi, të cilat mund të merren automatikisht. Lista e dokumenteve të paraqitura nga aplikantët shpesh përfshin të dhëna të cilat janë tashmë të disponueshme në regjistrat shtetërorë, si certifikatat e shlyerjes së detyrimeve tatimore apo informacionet nga bankat.
- **Afate të zgjatura:** Procedurat për miratimin e licencave dhe autorizimeve janë të gjata dhe të komplikuar.
- **Paqartësi në kërkesat dhe hapat proceduralë:** Formulimet për disa dokumente janë të paqarta, duke lejuar hapësirë për kërkesa shtesë të paparashikuara nga aplikantët.
- **Mungesa e bashkëpunimit ndërinstitucional:** Për zhdoganimin e mallrave me përdorim të dyfishtë, mungesa e një marrëveshjeje ndërmjet AKSHE dhe Doganave krijon vonesa në procesin e autorizimeve dhe shpërndarjen e mallrave.

### Rekomandime

Në kuadër të takimit, janë propozuar dhe dakordësuar masat e mëposhtme:

- **Reduktimi i dokumentacionit:** Eliminimi i kopjeve fizike të dokumenteve si ID dhe mandatpagesat, duke i zëvendësuar me verifikime automatike nga regjistrat shtetërorë. Kombinimi i disa dokumenteve të ngjashme në një formular të vetëm për të shmangur përsëritjet.
- **Kalimi në aplikime online:** Transformimi i formularëve të licencave dhe autorizimeve në formate dixhitale përmes platformës e-Albania, duke lehtësuar aksesin dhe duke eliminuar plotësisht kërkesat për dokumente fizike.

- **Standardizimi i procedurave:** Krijimi i formularëve të unifikuar dhe shtojcave standarde për të gjithë shërbimet, duke eliminuar paqartësitë dhe hapësirën për shtesa të paparashikuara.
- **Forcimi i koordinimit ndërinstitucional:** Organizimi i një takimi mes AKSHE dhe Doganave për të siguruar një marrëveshje që mundëson autorizimin dhe zhdoganimin e mallrave me përdorim të dyfishtë në mënyrë më të shpejtë dhe më të sigurt.

### Rezultatet Kryesore

- Reduktimi i dokumenteve me 21%, duke hequr kërkesat për 50 dokumente aktuale.
- Implementimi i standardizimit për të gjitha shërbimet dhe formularët, duke përmirësuar aksesin dhe transparencën për aplikantët.

### Raport Analitik mbi Derregullimin e Shërbimeve MM

#### 1. Totali i Shërbimeve të Ofruara

Ministria e Mbrojtjes ofron gjithsej 50 shërbime publike, të cilat janë analizuar në kuadër të procesit të derregullimit.

#### 2. Shërbime që do të Përmirësohen

Në total, 38 shërbime, ose 76%, do të përfshihen në procesin e përmirësimit përmes reduktimit të dokumentacionit dhe procedurave të ndërlikuara.

#### 3. Totali i Dokumenteve

Për këto shërbime aktualisht kërkohen gjithsej 237 dokumente.

#### 4. Dokumentacioni që Reduktohet

Është propozuar eliminimi i 50 dokumenteve, që përbën një reduktim prej 12% të totalit të dokumenteve të kërkuara.

#### 5. Shërbime për të Cilët Reduktohet Koha e Ofrimit

Nuk ka.

#### 6. Totali i Kohës së Ofrimit të Shërbimeve

Aktualisht, për përfundimin e shërbimeve nevojiten gjithsej 343 ditë.

#### 7. Koha e Ofrimit të Shërbimeve që Reduktohet

Nuk Ka.

#### 8. Ndryshime Ligjore të Nevojshme

Procesi i derregullimit kërkon përmirësime të bazës ligjore dhe nënligjore, përfshirë:

- Ligje të Ndryshuara: 1 ligj.
- Vendime të Këshillit të Ministrave (VKM): 4 VKM.



## 5. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR)

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) ofron një sërë shërbimesh që mbulojnë nevojat e fermerëve, bizneseve të agrosektorit dhe institucioneve të tjera të lidhura me bujqësinë dhe zhvillimin rural. Përmes një strukture të diversifikuar, ministria siguron licenca dhe autorizime për aktivitete të tilla si blegtoaria, akuakultura dhe përdorimi i pesticideve, duke garantuar përputhshmërinë me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare. Një tjetër shtyllë e rëndësishme është mbështetja për fermerët, e cila realizohet përmes skemave kombëtare dhe programeve të Bashkimit Europian. Këto programe përfshijnë subvencione për prodhimin bujqësor, modernizimin e fermave dhe përmirësimin e infrastrukturës bujqësore. Siguria ushqimore përbën një tjetër prioritet, me ministrinë që lëshon certifikata veterinare dhe licenca për operatorët e biznesit ushqimor, si dhe autorizime për importin dhe eksportin e produkteve ushqimore dhe blegtoarale. Gjithashtu, MBZHR menaxhon burimet natyrore përmes ndarjes dhe monitorimit të karburantit për fermerët dhe dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit. Ministria ofron gjithashtu konsulencë teknike për fermerët dhe bizneset e agrosektorit, duke mbështetur përmirësimin e praktikave bujqësore dhe duke lehtësuar aplikimet për mbështetje financiare nga programe kombëtare dhe ndërkombëtare.

### Situata dhe Sfidat

Nga analiza e realizuar dhe konsultimet me grupet e interesit dhe përfaqësuesit e institucioneve të bujqësisë dhe zhvillimit rural, janë evidentuar sfidat e mëposhtme:

- **Dokumentacion i tepërt dhe i përsëritur:** Për shumë shërbime, si autorizimet për përdorimin e pesticideve dhe qiratë e tokave bujqësore, kërkohet një sasi e madhe dokumentesh që shpesh janë të panevojshme ose të përsëritura.
- **Koha e zgjatur e procedurave:** Për shembull, procedurat për autorizimet në blegtori dhe rinovimet e regjistrimeve mund të zgjasin deri në 55 ditë, duke shkaktuar vonesa të konsiderueshme për aplikantët.
- **Koordinimi i dobët ndërinstitucional:** Mungesa e integritit të të dhënave midis MBZHR-së, AKU-së dhe institucioneve të tjera krijon ngarkesë administrative për fermerët dhe bizneset që aplikojnë për shërbime të ndryshme.

### Rekomandime

Në përfundim të analizës dhe konsultimeve, janë propozuar këto masa për adresimin e sfidave:

- **Eliminimi i dokumenteve të tepërta:** Për shërbime si autorizimet veterinare dhe aplikimet për skemat kombëtare, janë propozuar eliminime të dokumenteve që mund të sigurohen automatikisht nga institucionet përkatëse.
- **Standardizimi i procedurave:** Janë krijuar formate të unifikuara për aplikimet, duke reduktuar konfuzionin dhe lehtësuar procedurat për fermerët dhe operatorët ekonomikë.
- **Shkurtimi i afateve kohore:** Për disa shërbime, si certifikatat e sigurisë ushqimore dhe aplikimet për subvencione, janë propozuar reduktime të ndjeshme të afateve për të përmirësuar përvojën e përdoruesve.
- **Përmirësimi i bashkëpunimit ndërinstitucional:** Është theksuar nevoja për ndërlidhjen e sistemeve ekzistuese midis MBZHR, AZHBR dhe AKU për të shmangur vonesat dhe për të lehtësuar shkëmbimin e informacionit.

## Rezultatet Kryesore

- **Reduktimi i dokumenteve:** Nga 51 dokumente të kërkuara për 43 shërbime, 15 janë propozuar për eliminim, që përfaqëson një ulje prej 29%.
- **Shkurtimi i afateve kohore:** Totali i kohës për përfundimin e shërbimeve është reduktuar me 510 ditë, që përfaqëson një ulje prej 46%.

## Raport Analitik mbi Derregullimin e Shërbimeve MBZHR

### 1. Totali i Shërbimeve të Ofruara

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ofron gjithsej 55 shërbime publike, të cilat janë analizuar në kuadër të procesit të derregullimit. Pas ndryshimeve, ky numër do të reduktohet në 43 shërbime përmes konsolidimit dhe thjeshtimit të procedurave.

### 2. Shërbime që do të Përmirësohen

Në total, 29 shërbime, ose 67%, do të përfshihen në procesin e përmirësimit përmes reduktimit të dokumentacionit dhe procedurave të ndërlikuara.

### 3. Totali i Dokumenteve

Për këto shërbime aktualisht kërkohen gjithsej 51 dokumente.

### 4. Dokumentacioni që Reduktohet

Është propozuar eliminimi i 15 dokumenteve, që përbën një reduktim prej 29% të totalit të dokumenteve të kërkuara.

### 5. Shërbime për të Cilët Reduktohet Koha e Ofritit

Koha e ofritit do të reduktohet për 20 shërbime, që përfaqësojnë 47% të totalit të shërbimeve.

### 6. Totali i Kohës së Ofritit të Shërbimeve

Aktualisht, për përfundimin e shërbimeve nevojiten gjithsej 1120 ditë.

### 7. Koha e Ofritit të Shërbimeve që Reduktohet

Pas zbatimit të ndryshimeve të propozuara, totali i kohës për ofrimin e shërbimeve do të reduktohet në 600-620 ditë, duke kursyer reth 510 ditë, që përbën një ulje prej 46% të kohës totale.

### 8. Ndryshime Ligjore të Nevojshme

Procesi i derregullimit kërkon përmirësime të bazës ligjore dhe nënligjore, përfshirë:

- Ligje të Ndryshuara: 1 ligj.
- Vendime të Këshillit të Ministrave (VKM): 1VKM.
- Urdhëra: Asnjë.
- Udhëzime: Asnjë.

## 6. Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI)

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) mbulon një gamë të gjerë shërbimesh, duke përfshirë zhvillimin ekonomik, promovimin e kulturës, mbështetjen e inovacionit dhe përmirësimin e procedurave për bizneset dhe qytetarët. Në bashkëpunim me institucionet e saj vartëse, MEKI ofron shërbime të cilat përfshijnë regjistrimin e biznesit, licencimin, mbrojtjen e pronës intelektuale, aksesin në fonde kulturore dhe lehtësimin e procedurave për investime. Institucionet vartëse si Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS), dhe institucione të tjera luajnë një rol kyç në realizimin e këtyre shërbimeve. Shërbimet ndaj biznesit përfshijnë procedura për regjistrimin e aktiviteteve ekonomike dhe licencimin për fusha të ndryshme si energjia, industria dhe kultura. Këto shërbime janë shpesh të ndërlidhura me mbrojtjen e pronës intelektuale, mbështetjen e investimeve të huaja dhe standardizimin e produkteve dhe shërbimeve. MEKI ofron gjithashtu një sërë shërbimesh të fokusuara në promovimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe artistike. Në këtë kontekst, institucione si Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit (AQSHF) dhe Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK) menaxhojnë hulumtime, aplikime për qira të ambienteve për aktivitete artistike dhe akses në fondet e arkivave kulturore.

### Situata dhe Sfidat

- **Dokumentacioni i tepërt dhe joefikas:** Shumë dokumente kërkohen nga aplikantët edhe kur ato mund të sigurohen përmes ndërveprimit institucional.
- **Procedura të gjata dhe komplekse:** Shumë shërbime të kulturës dhe ekonomisë kanë afate të gjata për shqyrtim dhe finalizim.
- **Mungesa e dixhitalizimit të plotë:** Shumë shërbime mbeten offline, duke krijuar barriera për qytetarët dhe bizneset.
- **Koordinimi ndërinstytucional i kufizuar:** Ka mungesë të sistemeve të integruara për të siguruar akses dhe ndarje të të dhënave në kohë reale.

### Rekomandime

- **Thjeshtimi i dokumentacionit:** Janë propozuar ndryshime për reduktimin e dokumenteve dhe krijimin e formularëve unifikuar.
- **Standardizimi i formulareve dhe procedurave:** Janë zhvilluar formate të unifikuara për aplikime dhe raportime për të shmangur konfuzionin.
- **Rritja e ndërveprimit ndërinstytucional:** Krijimi i sistemeve të integruara për të mundësuar verifikime të shpejta dhe për të reduktuar kohën e përgjigjes.

### Rezultatet Kryesore

- **Reduktimi i dokumenteve:** Nga 360 dokumente të kërkuara për 118 shërbime, 60 janë propozuar për eliminim, duke ulur barrën administrative me 17%.
- **Shkurtimi i afateve kohore:** Totali i kohës për përfundimin e shërbimeve është reduktuar me 224 ditë ose 11%

## Raport Analitik mbi Derregullimin e Shërbimeve MEKI

### 1. Totali i Shërbimeve të Ofruara

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) dhe institucionet në varësi ofrojnë gjithsej 118 shërbime.

### 2. Shërbime që do të Përmirësohen

Gjithsej 24 shërbime, ose 20% e totalit, do të përfshihen në procesin e derregullimit përmes heqjes së kritereve, dokumentacionit të tepërt dhe thjeshtimit të procedurave.

### 3. Totali i Dokumenteve

Aktualisht, për shërbimet e përmirësuara kërkohen 360 dokumente.

### 4. Dokumentacioni që Reduktohet

Është propozuar eliminimi i 60 dokumenteve, që përfaqëson një ulje prej 17% të totalit të dokumenteve për shërbimet e përmirësuara.

### 5. Shërbime për të Cilët Reduktohet Koha e Ofritit

Koha e ofritit do të reduktohet për 84 shërbime, që përfaqësojnë 71% të totalit të shërbimeve.

### 6. Totali i Kohës së Ofritit të Shërbimeve

Aktualisht, për përfundimin e shërbimeve nevojiten gjithsej 2128 ditë.

### 7. Koha e Ofritit të Shërbimeve që Reduktohet

Pas zbatimit të ndryshimeve të propozuara, totali i kohës për ofrimin e shërbimeve do të reduktohet me 224 ditë, që përbën një ulje prej 11% të kohës totale.

### 8. Ndryshime Ligjore të Nevojshme

- Ligje të Ndryshuara: asnje
- Vendime të Këshillit të Ministrave (VKM): 2 VKM.
- Urdhëra dhe Udhëzime: Asnje

## Lista e Akteve Derregulluese

### Vendime të Këshillit të Ministrave (2)

1. Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar (*Miratuar*)  
<https://www.qbz.gov.al/eli/vendim/2024/12/04/743/fa5ef24b-40b3-47e4-927f-79892881743d>
2. Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 391, datë 03.05.2017 "Për Përcaktimin e Procedurave të Regjistrimit dhe të Publikimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (*Miratuar*)  
<https://qbz.gov.al/eli/vendim/2024/11/20/724/06cd445c-4451-45d5-b5d3-5cd95f6afbe4>

### III. Anex – Lista e akteve derregulluese

#### 1. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM)

##### Lista e Akteve Derregulluese

###### Ligje (1)

1. Ligj nr. 30/2024 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 93/2015, "Për turizmin", i ndryshuar. (Miratuar) <http://qbz.gov.al/eli/ligj/2024/04/04/30>

###### Vendime të Këshillit të Ministrave (8)

1. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 59, datë 07.02.2024 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të dokumentacionit për subjektet që aplikojnë për statusin "investitor në strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, status special". (Miratuar) <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2024/02/07/59>
2. VKM Nr. 520 "Për disa ndryshime në VKM nr. 641/2014 "Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte", të ndryshuar. (Miratuar) <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2024/08/01/520>
3. VKM Nr. 526, datë 1.8.2024 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 229, datë 23.4.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit", të ndryshuar". (Miratuar) <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2024/08/01/526>
4. VKM Nr. 522, datë 1.8.2024 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 371, datë 11.6.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre", të ndryshuar". (Miratuar) <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2024/08/01/522>
5. VKM Nr. 524, datë 1.8.2024 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 285, datë 29.4.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret e vendosjes dhe të funksionimit të stacioneve sezonale të ankorimit/bregëzimit". (Miratuar) <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2024/08/01/524>
6. VKM Nr. 521, datë 1.8.2024 Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 692, datë 5.10.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores "kriteret për pajisjen me certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, detyrat, përgjegjësitë dhe kodin e etikës së tyre", të ndryshuar". (Miratuar) <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2024/08/01/521/6a7c1b47-bd55-4568-86f2-fa24cedc1701>

7. VKM Nr. 523, datë 1.8.2024 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 302, datë 10.5.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e ushtrimit, të miratimit e monitorimit të veprimtarive kërkimore-shkencore në zonat e mbrojtura mjedisore”. (Miratuar)  
<http://qbz.gov.al/eli/vendim/2024/08/01/523>
8. VKM Nr. 525, datë 1.8.2024 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 284, datë 29.4.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave, procedurave dhe kriterëve për pajisjen me certifikatën e ekspertit në fushën e pyjeve dhe kullotave”. (Miratuar)  
<https://qbz.gov.al/eli/vendim/2024/08/01/525/1760d1fb-88f6-4da5-9ad3-b446d71cb9d8>

## Udhëzim (1)

1. Udhëzimit të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 1, datë 06.05.2019 “Për përcaktimin e mënyrës së ndarjes së kuotave vjetore të importit të substancave të kontrolluara”, i ndryshuar. (Miratuar)  
<https://www.qbz.gov.al/eli/udhezim/2024/12/16/4/8f999234-8aab-4e63-ae28-31d8b3d89ad8>

## Urdhër (2)

1. Urdheri nr.19, datë 15.01.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhrin Nr. 267/2016, "Mbi miratimin e rregullores për menyren, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese" i ndryshuar, i cili parashikon reduktim dokumentacioni dhe një pjesë e tij do të sigurohet nga MTM-ja. (Miratuar)  
<http://qbz.gov.al/eli/urdher/2024/01/15/19>
2. Urdhri i Përbashkët nr.15, datë 15.01.2024 i Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural “Për miratimin e rregullores mbi funksionimin e Komisionit Vlerësues të certifikimit të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e agroturizmit procedurat e aplikimit, të vlerësimit paraprak dhe përfundimtar, si dhe pezullimi dhe/ose shfuqizimi i “Certifikatës paraprake” apo i “Certifikatës”. (Miratuar)  
<http://qbz.gov.al/eli/urdher/2024/01/15/15>

## 2. Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS)

### Lista e Akteve Derregulluese

#### Vendime të Këshillit të Ministrave (2)

1. Vendimi nr. 629, datë 10.10.2024 i Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 418, datë 10.5.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre”. (Miratuar).  
<http://qbz.gov.al/eli/vendim/2024/10/10/629>
2. Vendimi nr. 630, datë 10.10.2024, i Këshillit të Ministrave “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 466, datë 10.6.2020 i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të

procedurave për hapjen dhe mbylljen e institucioneve private të arsimit parauniversitar, në të cilat zhvillohen edhe lëndë fetare apo ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj”. (Miratuar). <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2024/10/10/630>

### Udhëzim (1)

1. Udhëzim nr.1, datë 14.1.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar. (Miratuar) <https://www.qbz.gov.al/eli/udhezim/2025/01/21/2/83104f0e-7e1d-4999-8f49-6863eb4d2066>

## 3. Ministria e Brendshme (MB)

### Lista e Akteve Derregulluese

#### Udhëzim (3)

1. Udhëzim Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr.64, datë 12.05.2022 “Për përcaktimin e kriterëve të veçanta të dhënies së certifikatës për ushtrimin e aktivitetit të ekspertit privat në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”. (Miratuar). <http://qbz.gov.al/eli/udhezim/2024/11/12/225>
2. Udhëzim Për procedurat për pajisjen me autorizim për veprimtarinë e lejuar me armë, regjistrimin e armës, administrimin e gëzhgojes në një bankë të dhënash dhe procedurat që kryhen pas dorëzimit në Policinë Shkencore”. (Miratuar) <http://qbz.gov.al/eli/udhezim/2024/10/18/198>
3. Udhëzim Për masën, kriteret dhe procedurat për tarifën financiare për veprimtarinë e lejuar me armë”; Udhëzim Përbashkët i MB dhe MF që shfuqizon atë me nr. 264/1, dt. 22.6.2015. (Miratuar) <http://qbz.gov.al/eli/udhezim/2024/11/08/221>

## 4. Ministria e Mbrojtjes (MM)

### Lista e Akteve Derregulluese

#### Ligje (1)

1. Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.46/2018 “Per kotrollin shteteror te transferimeve nderkombetare te mallrave ushtarake dhe te artikujve e teknologjive me perdorim te dyfishte”, te ndryshuar. (Miratuar) linku <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2024/07/26/89>

### Vendime të Këshillit të Ministrave (4)

1. Projektvendim “Për Disa Shtesa Dhe Ndryshime Në Vendimin Nr. 788, Datë 11.12.2019, Të Këshillit Të Ministrave, “Për Përbërjen Dhe Rregullat E Detajuara Për Organizimin, Funkionimin E Shpërblimin Financiar Të Komisionit Qendror Të Statusit ‘Dëshmor I Atdheut’ Miratuar Me Vendimin Nr. 80, Datë 05.02.2025. (Miratuar) <https://Qbz.Gov.Al/Eli/Vendim/2024/12/26/840/94d7d6a4-B817-49d1-B354-F2c974ea4850>

2. Projektvendim “Për Disa Ndryshime Në Vendimin Nr. 31, Datë 22.1.2020, Të Këshillit Të Ministrave, “Për Organizimin, Përbërjen, Funkcionimin Dhe Statusin E Autoritetit Të Kontrollit Shtetëror Të Eksperteve, Përcaktimin E Afateve, Të Mënyrës Dhe Të Procedurës Për Shkëmbimin E Informacionit Dhe Të Marrjes Së Mendimit Nga Institucionet E Tjera Të Përfshira Në Transferimet Ndërkombëtare Të Mallrave Të Kontrolluara, Si Dhe Përcaktimin E Procedurave Për Lëshimin E Garancive Dhe Kryerjen E Kontrollit Shtetëror” Miratuar Me Vendimin Nr. 842, Datë 26.12.2024. *(Miratuar)*  
<https://Qbz.Gov.AL/Eli/Vendim/2024/12/26/842/41e0451e-78c0-48b8-9f91-02650b1a2638>
3. Projektvendim “Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin Nr. 509, Datë 30.8.2023, Të Këshillit Të Ministrave, “Për Përcaktimin E Kushteve Të Posaçme Të Licencimit Dhe Autorizimit, Dokumenteve Shoqëruese, Që Paraqiten Për Pajisjen Me Licencë Apo Autorizim, Afatit Të Vlefshmërisë Së Licencës Dhe Autorizimit, Procedurave Të Shqyrtimit E Të Vendimmarrjes Dhe Afateve Për Kryerjen E Tyre, Si Dhe Procedurave Të Shfuqizimit/Pezullimit Të Licencave E Autorizimeve Për Prodhimin, Importimin, Eksportimin, Transitimin E Artikujve Piroteknikë” Miratuar Me Vendimin Nr. 840, Datë 26.12.2024. *(Miratuar)*  
<https://Qbz.Gov.AL/Eli/Vendim/2024/12/26/840/94d7d6a4-B817-49d1-B354-F2c974ea4850>
4. Projektvendim Për Përcaktimin E Formatit Të Raportit, Afatet Dhe Koha E Paraqitjes Së Raporteve. Miratuar Me Vendimin Nr.97, Datë 12.02.2025 Me Titullin E Ndryshuar “Për Përcaktimin E Formatit Të Raportimit, Afateve Dhe Kohës Së Paraqitjes Së Raporteve Nga Subjektet E Përfshira Në Transferimet Ndërkombëtare Të Mallrave Të Kontrolluara (Planifikuar Në Ppap 2025)  
<https://qbz.gov.al/eli/vendim/2025/02/12/97/964ab0fd-4a45-444c-9158-1db72c200cf6>

## 5. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR)

### Lista e Akteve Derregulluese

#### Ligje (1)

1. Ligji nr. 10 465/2011 “Për shërbimin veterinar”, i ndryshuar. *(Miratuar 2024)*. Linku  
<https://www.qbz.gov.al/share/psZUWdARQhqw6eskyC3TqQ>

#### Vendime të Këshillit të Ministrave (1)

1. Vendim nr. 724, datë 20.11.2024 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 538, datë 26.5.2009, të këshillit të ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar. *(Miratuar 2024)*.  
<https://qbz.gov.al/eli/vendim/2024/11/20/724/06cd445c-4451-45d5-b5d3-5cd95f6afbe4>



## 6. Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI)

### Lista e Akteve Derregulluese

#### Vendime të Këshillit të Ministrave (2)

1. Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar (*Miratuar*)  
<https://www.qbz.gov.al/eli/vendim/2024/12/04/743/fa5ef24b-40b3-47e4-927f-79892881743d>
2. Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 391, datë 03.05.2017 "Për Përcaktimin e Procedurave të Regjistrimit dhe të Publikimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (*Miratuar*)  
<https://qbz.gov.al/eli/vendim/2024/11/20/724/06cd445c-4451-45d5-b5d3-5cd95f6afbe4>